Vendim nr. 312, datë 02.10.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 02.10.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 9 (R) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **ROLANDI DEMKO,** përfaqësuar nga avokati Evis Miço, me prokurë të posaçme.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 41-2015-781(389), datë 25.02.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë; nr. 319, datë 05.11.2015 të Gjykatës së Apelit Korçë; nr. 00-2023-2498, datë 14.06.2023 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 15 e në vijim, 42, 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 11.06.2008 kërkuesi, në cilësinë e huamarrësit, dhe shtetasi K.K., në cilësinë e huadhënësit, kanë nënshkruar një kontratë huaje. Në vijim, huadhënësi i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë me kërkesëpadi kundër kërkuesit, me objekt përmbushjen e detyrimit që rrjedh nga kontrata e huas, pagimin e dëmit të pësuar e të fitimit të munguar, si dhe marrjen e masës së sigurimit të padisë.

2. Me vendimin nr.41-2014-3501 (1564), datë 23.10.2014, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë ka vendosur rrëzimin e padisë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim paditësi. Ankimi është regjistruar në kryesekretarinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë me nr.312 regj., datë 10.11.2014.

3. Kërkuesi ka pretenduar se ankimi kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë është paraqitur jashtë afatit ligjor, pasi paditësi ka qenë i pranishëm në shpalljen e vendimit, nëpërmjet avokates së tij, ndaj afati i ankimit përfundonte në datën 07.11.2014. Sipas kërkuesit, ankimi është paraqitur në gjykatë në datën 10.11.2014, pra jashtë afatit ligjor 15-ditor, për këtë arsye ai i është drejtuar gjykatës së shkallës së parë me kërkesë, me objekt kthimin e ankimit nr. 312, datë 10.11.2014, të depozituar nga paditësi kundër vendimit nr.41-2014-3501 (1564), datë 23.10.2014 të asaj gjykate, duke thirrur si person të tretë paditësin.

4. Me vendimin nr. 41-2015-781(389), datë 25.02.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se avokatja e paditësit (personi i tretë në këtë gjykim) ka qenë e pranishme në momentin e shpalljes së vendimit nr.1564 datë 23.10.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, prandaj afati 15-ditor i ankimit të paditësit (personi i tretë në këtë gjykim) ka filluar nga e nesërmja e shpalljes së vendimit, pra nga data 24.10.2014 (nenet 443 dhe 444 të Kodit të Procedurës Civile (*KPC*)). Sipas asaj gjykate, ka rezultuar se kryesekretaria e gjykatës së shkallës së parë ka konfirmuar se ankimi i paditësit (personi i tretë në këtë gjykim) është depozituar me postë, jo dorazi, dhe është paraqitur në gjykatë nga ana e postës në datën 10.11.2014, datë kur edhe është marrë në dorëzim nga sekretarja regjistruese, si dhe nuk ka shkresë tjetër të depozituar nga "Albanian Courier". Për sa i përket përcaktimit të datës, në të cilën është

depozituar ky ankim në "Albanian Courier", gjykata e shkallës së parë në analizë të të gjitha provave të paraqitura (dëftesat e dërgesave të paraqitura në gjykim nga paditësi (personi i tretë në këtë gjykim) dhe të pakontestuara nga kërkuesi), ka vlerësuar se ai është depozituar në "Albanian Courier" në datën 06.11.2014, bazuar në faktin se dërgesa me kod 03918756-2 (e cila i përket këtij ankimi), marrë në dorëzim nga sekretarja regjistruese në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, në datën 10.11.2014, është dorëzuar në "Albanian Courier" nga paditësi (personi i tretë në këtë gjykim), në datën 06.11.2014. Po kështu, sipas gjykatës së shkallës së parë, data 08.11.2014 nuk lidhet me datën e depozitimit të ankimit nga paditësi (personi i tretë në këtë gjykim) në postën "Albanian Courier", por me datën e hedhjes në sistem të të dhënave për këtë dërgesë, ndaj fakti se ankimi i depozituar në "Albanian Courier" nga paditësi (personi i tretë në këtë gjykim) në datën 06.11.2014 është dorëzuar në gjykatë në datën 10.11.2014, pra pas katër ditësh, nuk mund të vërë në dyshim depozitimin e saj në postë në datën 06.11.2014, për aq kohë sa nga të gjitha provat e paraqitura ka rezultuar tërësisht i provuar depozitimi i dërgesës në datën 06.11.2014. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

5. Me vendimin nr. 319, datë 05.11.2015, Gjykata e Apelit Korçë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, me arsyetimin se kjo e fundit ka bërë objekt të shqyrtimit gjyqësor të gjitha pretendimet e kërkuesit, të cilat, pasi i ka ballafaquar me provat e administruara gjatë gjykimit dhe ligjin e zbatueshëm në rastin konkret, me të drejtë i ka gjetur të pabazuara. Gjykata e apelit, sikurse edhe gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar se ka rezultuar e provuar gjatë gjykimit që paditësi (personi i tretë në këtë gjykim) e ka depozituar ankimin kundër vendimit nr.1564 datë 23.10.2014 të Gjykatës së Rrethit Korçë pranë shërbimit postar (Albanian Courier) më 06.11.2014, pra brenda afatit 15-ditor të ankimit të parashikuar në nenin 443 të KPC-së. Sipas gjykatës së apelit, bazuar në paragrafin e dytë të nenit 149 te KPC-së... a*fati nuk quhet i humbur, kur kërkesa ose akti është dërguar me postë edhe në ditën e fundit të afatit...* afati i ankimit për paditësin (person i tretë në këtë gjykim) përfundonte më 07.11.2014, ndërkohë që ai e ka depozituar atë me postë një ditë para, duke qenë i parëndësishëm për efekt të humbjes së afatit momenti i mbërritjes së tij në gjykatë, më 10.11.2014. Gjykata e apelit ka vlerësuar se, ndryshe nga sa pretendohet në ankimin e paraqitur, paditësi (person i tretë në këtë gjykim) ka plotësuar detyrimin ligjor për depozitimin e ankimit me postë brenda afatit ligjor dhe ai nuk mund të penalizohet duke humbur të drejtën e ankimit, për shkak të problemeve në punën e përditshme të

shërbimit postar, ose për shkak të interpretimeve lidhur me momentin e lidhjes së kontratës së shërbimit postar. Sipas asaj gjykate, me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se në datën 10.11.2014 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë është depozituar një dërgesë e vetme nga paditësi (person i tretë në këtë gjykim) me anë të "Albanian Courier", dërgesë e marrë në dorëzim nga sekretarja regjistruese në gjykatën e shkallës së parë, dhe kryesekretaria konfirmon faktin se ankimi i paditësit (person i tretë në këtë gjykim) është depozituar pikërisht në datën 10.11.2014, me anë të "Albanian Courier" me dërgesën me kod 03918756-2. Po kështu, sipas gjykatës së apelit, ankimi është depozituar në postë në datën 06.11.2014, sikurse ka rezultuar nga tërësia e provave të administruara, duke u konfirmuar edhe nga formularët e depozitimit të objektit postar, ndërkohë që hedhja e të dhënave në sistem mund të bëhej edhe në një moment të mëvonshëm, sikurse ka ndodhur në rastin konkret. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesi.

6. Me vendimin nr.00-2023-2498, datë 14.06.2023, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit me arsyetimin se ai nuk përmbante asnjë prej shkaqeve të parashikuara nga neni 472 i KPC-së. Gjykata e Lartë ka vlerësuar se gjykata e apelit ka respektuar dispozitat e ligjit procedural dhe material dhe se vendimi i saj nuk binte në kundërshtim me praktikën gjyqësore të Kolegjit Civil ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

7. Në datën 09.06.2026 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të Ligjit Organik të Gjykatës, bazuar në nenet 15, pika 2, dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore të anëtarëve të Gjykatës, sipas nenit 18, pika 1, shkronja "b", të po këtij ligji.

II

Pretendimet e kërkuesit

8. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e *drejta për një proces të rregullt ligjor,* e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

8.1. *Parimit të paanshmërisë,* pasi gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë luajtur një rol proaktiv në mbrojtje të interesave të paditësit, person i tretë në procesin gjyqësor, objekt i

ankimit kushtetues individual, duke mos marrë në shqyrtim provat e paraqitura nga kërkuesi dhe vlerësimin e tyre.

8.2. *Standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi kërkuesi nuk ka marrë përgjigje për pretendimet të ngritura në rekurs për shkeljen e ligjit procedural. Vendimit të Gjykatës së Lartë i mungon arsyetimi ligjor lidhur me marrjen e provës shkresore në gjykatë, konkurrimin e provave shkresore në gjykim në raport me thëniet e dëshmitarëve dhe me përcaktimin e autoritetit që konfirmon depozitimin e ankimit në Gjykatë.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

9. Gjykimi kushtetues mund të vihet në lëvizje vetëm nëse përmbushen kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës, të parashikuara nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private ose publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara nga Kushtetuta. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore për shqyrtimin paraprak të kërkesës.

10. Kolegji vë në dukje se kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, ndaj mjafton mosplotësimi qoftë edhe i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes, Kolegji mund të verifikojë një ose më shumë prej këtyre kritereve, pa qenë i detyruar të ndjekë një radhë të paracaktuar të analizës. Mospërmbushja e njërit prej tyre, me pasojë moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kritereve të tjera. Mbi këtë bazë, në rastin konkret, Kolegji çmon të ndalet në kriterin e legjitimimit *ratione temporis*.

11. Në lidhje me legjitimimin *ratione temporis*, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja "b", të Ligjit Organik të Gjykatës, ankimi kushtetues individual shqyrtohet nga Gjykata kur kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se në rastin kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit *(shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese)*. Lidhur me llogaritjen e afatit të ankimit kushtetues individual, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka pohuar se duhet shpjeguar mënyra në të cilën individi mund të sigurojë provën e datës së njoftimit ose përse vetëm individi duhet të ketë barrën e provës në këtë drejtim. Sipas saj, i takon në radhë të parë, Gjykatës së Lartë të sigurojë që në dosjen e saj të çështjes të ketë prova për datën e dorëzimit të vendimit palëve (*shih Ibrahimi dhe të tjerë k. Shqipërisë, datë 14.01.2025, § 13*).

12. Gjykata ka theksuar se shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës. Nëse mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesi në gjykatë është, përpara së gjithash, kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit (*shih vendimet nr. 40, datë 22.12.2022; nr. 29, datë 01.11.2022; nr. 11, datë 21.04.2022 të Gjykatës Kushtetuese*). Megjithatë, sipas Gjykatës, ndonëse aksesi në gjykatë është kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit, ai mund të kufizohet kur bëhet fjalë për kushtet e pranueshmërisë së një ankimi, siç janë afatet e përcaktuara në Kushtetutë dhe në ligje, të cilat janë në funksion të parimit të sigurisë juridike (*shih vendimet nr. 42, datë 22.12.2022; nr. 9, datë 07.02.2017; nr. 18, datë 31.03.2014 të Gjykatës Kushtetuese*). Përcaktimi i afateve nuk përbën një qëllim në vetvete, por bëhet për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Mospërcaktimi i tyre do të çonte në një situatë të tillë, ku konfliktet gjyqësore asnjëherë nuk do të zgjidheshin përfundimisht mes palëve dhe situata e tyre do të ishte e pasigurt, pasi në çdo moment një e drejtë e fituar me një vendim gjyqësor, potencialisht do të mund të cenohej ose prekej me një vendim të dhënë nga një gjykatë më e lartë (*shih vendimet nr. 27, datë 18.05.2023; nr. 29, datë 15.05.2014; nr. 5, datë 02.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

13. Në çështjen konkrete, Kolegji konstaton se vendimi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesi, ai i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, mban datën 14.06.2023, ndërsa ankimi kushtetues

individual është paraqitur në Gjykatë më 09.06.2026 (sipas shërbimit postar). Për qëllime të këtij shqyrtimi, Gjykatës së Lartë i është kërkuar informacion, e cila, në datën 27.07.2026, ka sqaruar se vendimi i kundërshtuar është publikuar në faqen e saj zyrtare në datën 06.09.2023 dhe se palët janë njoftuar nominalisht në të njëjtën datë, duke vënë në dispozicion korrespondencën elektronike ndërmjet sekretarisë së Gjykatës së Lartë dhe palëve, nga ku ka rezultuar se në datën 06.09.2023, vendimi i Gjykatës së Lartë i është njoftuar elektronikisht mbrojtësit me prokurë të kërkuesit. Në lidhje me këtë fakt, në kërkesën drejtuar Gjykatës, kërkuesi ka pretenduar se ka marrë dijeni për vendimin vetëm kur i është drejtuar sekretarisë së Gjykatës së Lartë në datën 11.03.2026 për t'u informuar zyrtarisht për çështjen e tij dhe se ankimi është paraqitur në Gjykatë brenda afatit ligjor 4-mujor.

14. Ndodhur në këto kushte, Kolegji konstaton se Gjykata e Lartë është investuar nga kërkuesi nëpërmjet rekursit, për kundërshtimin e vendimit të gjykatës së apelit, e cila në të njëjtën linjë arsyetimi me gjykatën e shkallës së parë kishte vendosur rrëzimin e kërkesës për kthimin e ankimit të palës kundërshtare në procesin e parë gjyqësor mes tyre, duke u përfaqësuar me avokat, rrethanë kjo që tregon se ai kishte interesin dhe mundësitë për të ndjekur fatin e rekursit të tij. Ndërkohë, nga komunikimi elektronik me Gjykatën e Lartë rezulton e provuar se kjo e fundit ka njoftuar mbrojtësin me prokurë të kërkuesit në procesin gjyqësor në adresën elektronike të tij. Për rrjedhojë, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual i kërkuesit është dorëzuar në Gjykatë rreth dy vjet e nëntë muaj, tej afatit ligjor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i Ligjit Organik të Gjykatës.

15. Në kushtet kur ky kriter paraprak nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kritereve të tjera të pranueshmërisë bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

16. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja "ç", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.